



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 20/15, DATË 06 / 06 / 2023

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “JALA
ENTERTAINMENT PARK” ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRIA “SOLEIL &
SEA” SH.P.K ME NIUS L21926005F**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Vlera e investimit të projektit “Jala Entertainment Park” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë rreth 72,000,000 (shtatëdhjetë e dy milion) Euro, prej të cilave investimi ekzistues vlerësohet në rreth 7,000,000 (shtatë milion) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës së realizimit të investimit dhe operimit, numri i të punësuarve parashikohet të jetë 620 (gjashtëqind e njëzet) persona.
- Projekti do të realizohet nga subjekti Soleil & Sea sh.p.k NIPT L21926005F. Shoqëria ka investuar në ndërtimin e strukturave të hotelierisë të cilat konsistojnë në forma duke rikonstruktuar ekzistueset, ashtu si dhe duke bërë ndërtime të reja.
- Për subjektin zhvillues “Soleil & Sea” sh.p.k. është miratuar Leja e Zhvillimit me Vendimin Nr. 26, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: Kompleks turistik, hoteleri dhe shërbime me vendodhje në Jalë, Bashkia Himarë”.
- Për subjektin “Soleil & Sea” sh.p.k. është miratuar Leja e Ndërtimit Nr. 887/10, datë 21.09.2018 për objektin “Resort Turistik Soleil 2, me vendodhje në Jalë, Bashkia Himarë, sipas Vendimit Nr. 14, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Ky resort është i përfunduar.
- Për subjektin “Soleil & Sea” sh.p.k. është miratuar Statusi “Investitor/Investim strategjik procedurë e veçantë” me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 20/5, datë 1/08/2019.
- Për subjektin “Soleil & Sea” sh.p.k. është miratuar Leje Ndërtimi Nr. 127/5, datë 06.02.2020 për objektin “Resort Turistik Vip Hotel” me vendodhje në Jalë, Bashkia

Himarë, sipas vendimit Nr. 14, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

- Për shkak të problematikave të shumta në këtë zonë, për arsye të mungesës së regjistrimit fillestar, nuk është bërë i mundur realizimi i projektit të investimit brenda afatit dy vjeçar të kohëzgjatjes së statusit “Investitor/Investim strategjik procedurë e veçantë” miratuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 20/5, datë 1/08/2019.
- Masat kryesore mbështetëse që kërkon subjekti aplikues për realizimin e këtij projekti investimi në zbatim të nenit 27 dhe nenit 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar, janë vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin e investimit me një sipërfaqe prej 22 ha, si dhe e drejta e përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonës përkatëse të plazhit në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik.

Nga verifikimi hartografik rezulton se zona e kërkuar, nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar sistematik, por aktualisht për këtë zonë ka përfunduar faza e afishimit publik bazuar në nenin 31 të Ligjit 111/2018 ‘Për Kadastrën’ si dhe faza e trajtimit të ankesave në bazë të nenit 33 të Ligjit 111/2018 ‘Për Kadastrën’.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka konfirmuar se janë verifikuar koordinatat e zonës bregdetare të cilat janë pjesë e listës së stacioneve bregdetare sipas VKM Nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të verpimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Bregdetit konfirmon se parcelat HI-74, HI-75, HI-76 dhe HI -77, sipas Aneks 2 të këtij vendimi, rezultojnë me ngjyrë të kuqe, të tipologjisë “Zonë e Menaxhuar/Investitor Strategjik” dhe për këto parcela nuk ka aplikime apo subjekte që disponojnë një kontratë në fuqi.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Jala Entertainment Park” me subjekt aplikues shoqëria "Soleil & Sea" sh.p.k me NIUS L21926005F dhe shtyrje të afatit të vlefshmërisë së statusit për një periudhë 4 (katër) vjeçare, nga data e njoftimit të këtij vendimi, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit si dhe afateve të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit të investimeve strategjike.
2. Projekti strategjik parashikon realizimin e një kompleksi turistik i cili do të zhvillohet në Zonën Kadastrale 3844, në Jalë, Vuno, Himarë.
3. Realizimi i kompleksit turistik ndahet në disa faza ku përfshihen: Belvedere dhe dhoma pushimi; Hotele VIP dhe struktura mbështetëse; Jala New Hill dhe struktura mbështetëse.
4. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, 22, 24, 27 dhe neni 29 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;

- b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
- c) Miratohet në parim masa mbështetëse konsolidim toke, në përputhje me nenin 21, pika c, të Ligj Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- d) Miratohet në parim masa mbështetëse vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore me sipërfaqe prej 22 ha, në ZK. 3844, sipas koordinatave në KRGJSH të Aneks 1 të këtij vendimi dhe hartës së afishimit publik ku janë përcaktuar numrat e pasurive që prek projekti në Aneksin 1, për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik, me tarifën simbolike 1 Euro.

Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme, për të gjitha fazat e projektit, si dhe mënyra dhe afatet e vënies në dispozicion të kësaj pasurie të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për investimet strategjike.

Procedura për këtë masë mbështetëse parashikohet në Kreun II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2015 "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike (FPPMIS)". Kalimi në FPPMIS i pronës shtetërore në ZK. 3844, kërkon ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të nevojshme në fuqi të parashikuara në legjislacionin e pronave të paluajtshme shtetërore, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu pasi të saktësohet zëri kadastral “kullotë”, pas përfundimit të regjistrimit sistematik fillestar, të ndryshohet ky zë dhe të reflektohet ndryshimi në fondin kullosor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 5. Në zbatim të nenit 29 të Ligjit Nr.55/2015, i ndryshuar, miratohet në parim masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit, në parcelat HI-74, HI-75, HI-76 dhe HI -77, sipas koordinatave të konfirmuara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Aneks 2 i këtij vendimi, me një afat 30 (tridhjetë) vjeçar. Miratimi përfundimtar, planvendosja e vijës bregdetare sipas stacioneve të miratuara të plazhit dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave.
- 6. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 7. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Jala Entertainment Park” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
- 8. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
- 9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të propozuar në Këshillin e

Ministrave vendimin për kalimin e pronës shtetërore në ZK. Nr. 3844, sipas Aneks 1 të këtij vendimi dhe hartës së afishimit publik të konfirmuar nga ASHK, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), sipas parashikimeve të pikës 5/c dhe 5/d, të këtij vendimi.

10. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit të investimit strategjik “Jala Entertainment Park”, sipas parashikimeve të pikës 5/c dhe 5/d, të këtij vendimi.
11. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës që pasi të saktësohet zëri kadastral “kullotë”, pas përfundimit të regjistrimit sistematik fillestar, të ndryshohet ky zë dhe të reflektohet ndryshimi në fondin kulloror në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik.
13. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për paraqitjen dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në regjistrin kadastral lidhur me zonën në zhvillim. Për çdo ndryshim të hartës së afishimit publik, të njoftohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë me qëllim reflektimin e ndryshimeve përkatëse.
14. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit nga ana e autoriteteve publike të masave të përfshira në Planin e Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
15. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “JALA ENTERTAINMENT PARK”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Jala Entertainment Park”

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “Jala Entertainment Park”, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “Jala Entertainment Park”, është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitorët:

Subjekti "Soleil & Sea" sh.p.k me NIUS L21926005F kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Vënie në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore ndodhur në zonën Jalë-Vuno, Bashkia Himarë	Po	ASHK MFE	Kjo masë parashikohet në Nenin 27 “Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike” në Ligjin Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015.	Vendosja e pasurisë në dispozicion të projektit dhe nënshkrimin e kontratë ndërmjet subjektit dhe MFE.		
Furnizimi me ujë dhe energji elektrike	Po me kusht	MIE	Subjekti duhet të ketë parasysh mbas miratimit për mundësinë për lidhjen me infrastrukturën dytësore duke përfshirë lidhjen me pikat ekzistente të energjisë “Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” nenit 27 të tij “Lidhja me rrjetin”, Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese. ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta			

			<p>të pikës së lidhjes.</p> <p>Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshirojnë të lidhet me rrjetin informacion të plotë, përfshirë:</p> <p>a) një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar;</p> <p>b) afatin e nevojshëm e të arsyeshëm për përpunimin e kërkesës dhe të realizimit të lidhjes me rrjetin.</p> <p>Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të licencuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Për sa i përket kostove për lidhjen me rrjetin. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj, qëllimi i synuar, modeli i konsumit, kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen, statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes. Kur lidhja realizohet prej operatorit të sistemit, kostot e lidhjes parapaguhet nga pala kërkuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga</p>			
--	--	--	--	--	--	--

operatorët e rrjetit. Në rast të lidhjes së përdoruesve të rinj të rrjetit, pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të aseteve apo në përfundim të autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes, nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre kalon tek operatori i rrjetit. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej përdoruesit.

Neni 29

Aksesi i palëve të treta

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifata dhe të publikuara nga ERE. Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të

			<p>rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë aksesin në rrjetin e tyre, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.</p> <p>3. Në rast se një pale të interesuar i është refuzuar aksesin në rrjet, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes pranë ERE-s.</p> <p>4. Në rast refuzimi të aksesit, ERE, nëpërmjet operatorit të rrjetit, i siguron palës së interesuar informacionin shtesë të nevojshëm.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

Kërkohe marrja në përdorim të vijës bregdetare.	Po	MTM AKB Bashkia Himarë	Kjo masë parashikohet në nenin 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar. Masa miratohet me VKM, propozimin e të cilit në Këshillin e Ministrave e bën MTM.	Verifikimet në terren, konfirmimi i planvendosjes sipas stacioneve të miratuara të plazhit për zonën në fjalë dhe tarifa e përdorimit konfirmohen nga Bashkia Himarë.		
---	----	---------------------------------	---	---	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE
KRYEMINISTËR
EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO